

L I G J
Nr.7788, datë 9.2.1994

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.7777, DATË 22.12.1993 “PËR SISTEMIN E TAKSAVE
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 13 dhe 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Neni 1

Në fund të nenit 2 të shtohet fjalët:

- taksë vjetore për regjistrimin e përvitshëm të automjeteve.

Neni 2

Në nenin 7, në pikën për taksat nacionale, shtohet nënpika “n”

- taksa vjetore për regjistrimin e përvitshëm të automjeteve caktohet sipas lidhjes nr.7.

Neni 3

Në nenin 8, në pikën A për taksat nacionale, shtohen nënpika “m” dhe 1 me këtë përmbajtje:

m. Për taksën për regjistrimin e automjeteve 3 për qind

1. Për vjeljen e taksës për regjistrimin e automjeteve ngarkohet Inspektorati Rrugor i Ministrisë së Rendit Publik.

Neni 4

Të ardhurat nga kjo taksë të përdoren krejtësisht për përmirësimin e sistemit të sinjalizimit rrugor.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

Shpallur me dekretin nr.776, datë 17.2.1994 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.

LIDHJA NR.7

TAKSA PËR REGJISTRIMIN E AUTOMJETEVE

	Në lekë
1. Për motoçikleta	500
2. Për autovetura	2000
3. Për kamionë	
deri në 3 tonë	3000
nga 3-8 tonë	4000

nga 8-13 tonë	5000
mbi 13 tonë	6000
4. Për mikrobuzët	4000
5. Për autobuzët	
deri në 30 vende	5000
30-50 vende	6000
mbi 50 vende	7000